VENDIM
Nr. 165, datë 11.4.1997

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM QEVERITAR PËR KOORDINIMIN E VEPRIMTARISË SHTETËRORE NË MARRËDHËNIET ME PËRFAQËSUESIT E MISIONEVE/FORCAVE SHUMËKOMBËSHE TË PRANISHME NË SHQIPËRI

Duke u bazuar në rezolutën 1101 (1997) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe në vendimin nr.160, datë 27.3.1997 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr.8203, datë 30.3.1997 "Për pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe në mbështetje të operacioneve humanitare", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e komisionit të posaçëm qeveritar për koordinimin e veprimtarisë shtetërore në marrëdhëniet me përfaqësuesit e misioneve/forcave shumëkombëshe të pranishme në Shqipëri.

2. Komisioni ka si detyrë kryesore të koordinojë veprimtarinë e institucioneve shtetërore për të përgatitur gjithë kuadrin e nevojshëm ligjor e teknik për ardhjen dhe veprimin e papenguar të misioneve/forcave shumëkombëshe, mbajtjen e komunikimit të rregullt me to, si dhe trajtimin e problemeve të ndryshme që hasen në veprimtarinë e tyre, duke u sugjeruar zgjidhjet e duhura institucioneve përkatëse.

3. Kryetar i këtij komisioni caktohet Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

4. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, veprimtaria e të cilave është e lidhur drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e misioneve/forcave shumëkombëshe të pranishme në Shqipëri, sipas listës së bashkëngjitur këtij vendimi. Lista emërore miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, me propozimin e kryetarit të komisionit.

5. Institucionet që kanë përfaqësues të tyre anëtarë të komisionit, të krijojnë të gjitha kushtet lehtësuese për veprimtarinë e komisionit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

LISTA EMËRORE E KOMISIONIT TË POSAÇËM QEVERITAR PËR KOORDINIMIN E VEPRIMTARISË SHTETËRORE NË MARRËDHËNIET ME PËRFAQËSUESIT E MISIONEVE/FORCAVE SHUMËKOMBËSHE TË PRANISHME NË SHQIPËRI

1. Z. Pavli Zëri	Kryetar	Sekretar Shteti në Ministrinë e Jashtme
2. Z. Ali Kazazi	Zv. Kryetar	Sekretar Shteti në Ministrinë e Mbrojtjes
3. Z. Lush Përbali	Zv. Kryetar	Sekretar Shteti në Ministrinë e Brendshme
4. Z. Fatmir Hakani	Anëtar	Këshilltar i Kryeministrit
5. Z. Ferit Hoxha	Anëtar	Drejtor Politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme
6. Z. Albert Beja	Anëtar	Drejtor Politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme
7. Z. Kristo Micaco	Anëtar	Drejtor në Ministrinë e Financave
8. Z. Alket Kashahu	Anëtar	Përfaqësues i pushteti lokal
9. Z. Sali Metani	Anëtar	Drejtor në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit